



Republika e Kosovës
Republika Kosovo / Republic of Kosovo
Komuna e Rahovecit
Opština Orahovac/Municipality of Rahovec
Drejtoria për Kulturë, Rini dhe Sport



Odeljenje za Kulturu, Omladinu i Sport / Department of Culture, Youth and Sport

13 Nr. Zyrtar -2023



THIRRJE PUBLIKE

Për anëtarë të komisionit për vlerësimin e projekt- propozimeve të OJQ-ve

Bazuar në Rregulloren e Ministrisë së Financave Nr. 04/2017 mbi kriteret, standardet dhe procedurat e financimit publik të OJQ-ve, në Nenin 8, paragrafin 3.2, që pjesë e çdo Komisioni Vlerësues për vlerësimin e projekt- propozimeve të OJQ-ve, të pranuar sipas thirrjes publike, duhet të jenë dy përfaqësues nga grupi i ekspertëve të jashtëm, duke përfshirë një përfaqësues të OJQ-ve.

Për këtë qëllim, DKRS-ja fton të gjithë të interesuarit që të aplikojnë për të qenë pjesë në cilësinë e anëtarit të Komisioni vlerësues, për të vlerësuar projekt- propozimet e dorëzuara nga OJQ-të.

Të gjithë kandidatët, të cilët nuk janë nën hetime apo me procedura penale dhe që kanë përvojë në shoqëri civile, me përparësi nga OJQ-të, që merren me fushën e sportit dhe të rinisë, mund të aplikojnë për pjesëmarrje në Komisionin Vlerësues, në cilesi të:

1. Një përfaqësues nga OJQ-të, që merren me fushëveprimtari sportive dhe rinore,
2. Një përfaqësues në cilësinë e ekspertit.

Të drejtë aplikimi kanë :

Të angazhuar në Organizatat joqeveritare aktive që veprojnë në Komunën e Rahovecit; Ekspertë të pavarur, të cilët kanë përvojë pune që nderlidhet me hartimin dhe me menaxhimin e projekteve në fushën e sportit dhe të rinisë.

Kandidatët duhet të plotësojnë këto kushte:

Duhet të kenë diplome universitare;

Te kenë përvojë në hartimin dhe në menaxhimin e projekteve të OJQ-ve sportive dhe rinore;

Të mos jenë të emëruar politikë, sherbyes civilë apo në pozita të ngjashme në administratën shtetërore.

- Kandidatët duhet t'i dorezojnë keto dokumente :

Një CV;

- Perfaqësuesit nga OJQ-të, duhet të dorëzojnë një letër nominimi nga udhëheqësi i OJQ-së, në të cilën dëshmohet se aplikuesi është i punësuar apo i angazhuar në organizatë.

- Përfaqësuesi në cilësinë e ekspertit, duhet të ketë diplomë universitare.

Dokumentet e kompletuara duhet të dërgohen në adresën e mëposhtme:

Komuna e Rahovecit,

Drejtoria për Kulturë, Rini dhe Sport

Sporteli nr 7- në ndërtesën e Komunës, Rr. Dëshmorët e Pashtrikut pn

Afati i apikimit nga data 9.2.2023, deri më datë 22.2.2023

Komisioni i themeluar nga DKRS-ja, do të bëjë vlerësimin e të gjitha aplikacioneve të pranuar dhe kandidatët të cilët i plotësojnë kriteret e përcaktuara, përmes kësaj ftese publike, do të jenë pjesë e Komisionit Vlerësues për subvencionimin e OJQ-ve për vitin 2023.



Rahovec, shkurt 2023

